



Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr.03/L-212 Ligji i Punës të Republikës së Kosovës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të Marrëveshjes së veçantë për grand për projektin: “Climate Appropriate Urban Development Wastewater Prishtina”, me nr. të Protokollit 3369, të datës 09.12.2022, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Ekonomisë, KfW-së dhe KRU “Prishtina” Sh.A., Prishtinë, publikon këtë:

KONKURS Për plotësimin e vendeve të lira

Titulli i pozitës:	<u>INXHINIER -HIDROTEKNIK</u>
Institucioni:	KRU “Prishtina” Sh.A Prishtinë
I përgjegjet:	Shefit të Shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit
Vendi i Punës:	Prishtinë
Koeficienti - paga:	815.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i ekzekutuesve :	4 (katër)
Kohëzgjatja e kontratës:	Kohë të pacaktuar, me një periudhë të punës provuese prej 6 muaj.
Orari i punës:	I plotë
Njohja e Gjuhës Angleze:	Mirë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Punon në kalkulimin e çmimeve për paramasë dhe paralogarit dhe përgatit apo kompletton dokumentet për projektet e ujësjellësit (kompletimin e tender dokumentit)
- Bashkëpunon dhe me shërbimet tjera në KRU Prishtina
- Pas koordinimit të punëve në zyre të planifikimit dhe punimit të projekteve sipas kërkesës së shërbimeve obligohet të përcillen zhvillimet e punimeve edhe në teren .
- Përgatit tërë dokumentacionin teknik për kryerjen e punëve dhe të njëjtin ia dërgon shefit të shërbimit të projektimit.
- Bashkëpunon dhe koordinon punën me stafin inxhinierik në hartimin e projekteve investive në fushën e Hidroteknikës
- Bënë mbikëqyrjen e implementimit të projekteve,
- Pranon punë dhe përgjegjësi të tjera nga udhëheqësit konform nevojave të kompanisë.
- Kryen punë tjera dhe i raporton Shefit të Shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Përgatitja arsimore/profesionale: Fakulteti Teknik / Hidroteknikë (Bachelor)

Përvoja e punës: 4 vite

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhëna personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- Aplikacionin e shkarkoni nga ueb faqja e KRU-P.
- Dokumentet për aplikimin tuaj: **Diplomën e përgatitjes shkollore, dëshmia e përvojës së punës, (e dëshmuar me pasqyrë të trustit), letër njoftimi, certifikatën që nuk jeni i dënuar dhe nën hetime jo me të vjetër se 6 muaj – vetëm nga Gjykata)** të skanuar, pastaj ngarkohen në aplikimin online të vegëza

www.kru-prishtina.com/rz/shpallje/. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, dëshmia e nostrifikimit të diplomës.

Titulli i pozitës:	<u>INXHINIER I GJEODEZISË</u>
Institucioni:	KRU "Prishtina" Sh.A Prishtinë
I përgjegjet:	Shefit te Shërbimit dhe Menaxherit te Departamentit
Vendi i Punës:	Prishtinë
Koeficienti - paga:	815.00 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i ekzekutuesve :	1 (një)
Kohëzgjatja e kontratës:	Kohë të pacaktuar, me një periudhë të punës provuese prej 6 muaj.
Orari i punës:	I plotë
Njohja e Gjuhës Angleze:	Mirë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Bashkëpunon ngushtë me ekspertin e GIS-it.
- Në bashkëpunim me ekspertin për matje është përgjegjës për të gjitha punët gjeodezike.
- Benë kontrollin e kualitetit të dhënave gjeodezike dhe hidroteknike sipas manualeve skicave, dhe planeve ekzistuese.
- Benë kontrollin e kualitetit të shënimeve ekzistuese në formatin DĚG dhe përgatitë këto të dhëna për futjen e tyre në GIS- (Sistemin Gjeo-Informativ).
- Futë të gjitha të dhënat në aplikimin e GIS-it.
- Këshillon dhe ndihmon departamentet e tjera të KRU "Prishtina" në zgjidhjen e çështjeve relevante inxhinierike që kanë të bëjnë me lëminë e GIS-it dhe gjeodezisë.
- Benë azhurimin e të dhënave gjeodezike dhe hidroteknike.
- Pranon punë dhe përgjegjësi të tjera nga udhëheqësi.
- I raporton Shefit te Shërbimit të Gjeodezisë dhe GIS-it.
- Të jetë komunikativ dhe i orientuar në punë grupore.
- Duhet të posedoj aftësi të shkëlqyera hartuese, analitike, komunikuese dhe nder njerëzore.
- Kryen punë tjera dhe i raporton Shefit të Shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Përgatitja arsimore/profesionale: Fakulteti Teknik, drejtimi Gjeodezisë, Gjeografisë dhe Gjeoinformatike (Bachelor)

Përvoja e punës: 4 vite

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhëna personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- Dokumentet për aplikimin tuaj: **Diplomën e përgatitjes shkollore, dëshmia e përvojës së punës, (e dëshmuar me pasqyrë të trustit), letër njoftimi, certifikatën që nuk jeni i dënuar dhe nën hetime jo me të vjetër se 6 muaj – vetëm nga Gjykata)** te skanuar, pastaj ngarkohen në aplikimin online te vegëza www.kru-prishtina.com/rz/shpallje/. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, dëshmia e nostrifikimit të diplomës.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi për pesë pozitat behët online. Dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave në konkurs. Pas aplikimit të suksesshëm do ta pranoni një email për konfirmim. Nëse nuk keni pranuar emailin konfirmues, atëherë kontaktoni në nr. tel. 0038/603-009.

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet në tabelën e shpalljeve të KRU-P, gjithashtu kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi, duke respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikacionit të kandidatit:

- Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- Intervista vlerësohet deri në njëzet (20) pikë,
- Jetë përshkrimi (CV)-ja vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë.

Kalendari i përafërt i procedurave të rekrutimit: brenda 25 ditësh do të organizohet testi me shkrim, brenda 25 ditësh intervista me gojë dhe njoftimi final brenda 30 dite nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas U.A. nr. 01/2024.

KRU “Prishtina” Sh.A. fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për pozitat e publikuara.

- Për më shumë informata për pozitën e lartpërmendur vizitoni ueb faqen: www.kru-prishtina.com, ikona “shpallje” – “vende të lira pune” dhe mund ta shkarkoni aplikacionin-CV-në për pozitën që aplikoni.

Vërejtje:

Për shkak të kërkesave të projektit, preferohet që kandidatet të jenë me të ri se 35 vjeç.

Aplikacionet e kandidatëve të pakompletuara do të refuzohen, edhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Kandidatët me kualifikime më të larta shkollore nuk do të kenë përparësi.

Afati për aplikim: deri me 06.11.2024 në ora 24:00.

